



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BYROJA KOMBËTARE E HETIMIT

Nr. 307 prot

Datë 28.02.2025

URDHËR

Nr. 188, Datë 28.02. 2025

Për

Miratimin e Programit të Trajnimeve të Byrosë Kombëtare të Hetimit për vitin 2025

Në mbështetje të Ligjit nr. 95/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar”, i ndryshuar, Ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, me qëllim planifikimin, organizimin dhe zhvillimin e trajnimeve, seminareve, kurse për punonjësit e Byrosë Kombëtare të Hetimit:

URDHËROJ:

1. Miratimin e Programit të Trajnimeve të Byrosë Kombëtare të Hetimit për vitin 2025, “Programi i Trajnimeve i Byrosë Kombëtare të Hetimit për vitin 2025”.
2. Ky Program i Trajnimeve të jetë fleksibël dhe të marrë në konsideratë edhe trajnime të tjera të paplanifikuara, të cilat mund të zhvillohen pas miratimit nga Drejtori i Byrosë Kombëtare të Hetimit.
3. Byroja Kombëtare e Hetimit, merr masa për planifikimin dhe pjesëmarrjen e personelit në vartësi të tyre në këto trajnime.
4. Drejtoria e Burimeve Njerëzore të marrë masa për shumëfishimin dhe shpërndarjen e Programit të Trajnimeve të Byrosë Kombëtare të Hetimit për vitin 2025.
5. Ngarkohen me njohjen dhe zbatimin e këtij urdhri të gjithë punonjësit e Byrosë Kombëtare të Hetimit.
6. Zbatimin e këtij urdhri e ndjek Drejtoria e Burimeve Njerëzore në Byronë Kombëtare të Hetimit.

Ky Urdhër hyn në fuqi menjëherë.

DREJTORI
Aida VEIZAJ (HAJNAJ)





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BYROJA KOMBËTARE E HETIMIT

Nr. 304/prot
12

Datë 28.02.2025

Nr	EMËRTIMI I TRAJNIMIT	Fillimi e Përfundimi	Pjesëmarrës	Donatori	Organizatori	Vendi i Zhvillimit
1.	Rikuperimi i pasurive dhe konfiskimin e zgjatur	28-29 janar 2025	4	OSBE	OSBE	Tiranë
2.	Përdorimi i softuer Mercure	28-30 janar 2025	3	EU4LEA	EU4LEA	SPAK
3.	Trajnimi i detyrueshëm "Prezantimi me Administratën Publike"	në datat 3, 4, 5, 6, 10, 11, 12, 13, 17 shkurt 2025	1	ASPA	ASPA	Pallati i Kongreseve
4.	Hartimi i shkresave	18 Shkurt 2025	3	ASPA	ASPA	Pallati i Kongreseve
5.	Kuptueshmëria dhe mirëadministrimi i procedurave administrative"	25 - 26 shkurt 2025	1	ASPA	ASPA	Online
6.	Tendencat e reja në lidhje me drogat e paligjshme sintetike	Gjatë vitit	2	INL, Ambasada e SHBA, Tiranë	ICITAP	ILEA-Budapest-Hungari
7.	Prodhimi 3D i Armëve	Gjatë vitit	2	Departamenti i Shtetit, Zyra Kundër Terrorizmit, Atasheu ICITAP, Sarajevë	ICITAP	Sarajevë, Bosnje dhe Hercegovinë
8.	Dark WEB 2	Gjatë vitit	1	ICITAP Kroacia	ICITAP	Kroaci
9.	Krimet mjedisore e kryera nga grupet e krimit të organizuar	Gjatë vitit	1	ICITAP Kroacia	ICITAP	Kroaci

10.	Trajnimi për armët e zjarrit	Gjatë vitit	60 Hetues		BKH	Akademia Sigurisë
11.	Parashikimet ligjore lidhur me veprën penale të korrupsionit. Historiku i rregullimit ligjor dhe ndryshimet ligjore ndër vite. Parashikimet ndërkombëtare mbi korrupsionin dhe zbatimi i Konventave të detyrueshme. Veprat penale të korrupsionit në Kodin Penal.	10 mars		Shkolla Magjistraturës	Shkolla Magjistraturës	Tiranë, Shqipëri
12.	Individualizimi i figurave të veprës penale të korrupsionit. Tipizimi i korrupsionit aktiv, ndërmjetësimit për korrupsion dhe korrupsionit. Përcaktimi i përgjegjësisë penale të ndërmjetësit korruptiv. Fusha e zbatimit të nenit 245/1 në raport me figurat e posaçme të veprave penale të korrupsionit. Veprimet hetimore dhe mjetet e posaçme të kërkimit të provës në veprat penale të korrupsionit. dhe zbatimi i bashkëpunimit në rastet e Kuptimi korrupsionit. Praktika gjyqësore. Korrupsioni dhe bashkëpunimi me krimin e organizuar.	11 mars 2025		Shkolla Magjistraturës	Shkolla Magjistraturës	Tiranë, Shqipëri
13.	Kuptimi dhe zbatimi i bashkëpunimit në rastet e korrupsionit. Praktika gjyqësore. Korrupsioni dhe bashkëpunimi me krimin e organizuar.	17 mars 2025		Shkolla Magjistraturës	Shkolla Magjistraturës	Tiranë, Shqipëri
14.	Korrupsioni, shpërdorimi i detyrës, shkelja e barazisë në prokurime, marrëdhëniet seksuale apo homoseksuale duke shpërdoruar detyrën, kufijtë ndarës dhe dallimet e këtyre veprave penale. Kompetenca lëndore e prokurorisë dhe gjykatës për hetimin, gjykimin dhe ekzekutimin e dënimeve penale të korrupsionit.	18 mars 2025		Shkolla Magjistraturës	Shkolla Magjistraturës	Tiranë, Shqipëri
15.	Regjistrimi i titujve të pronësisë. Regjistrimi fillestar dhe regjistrimi i akteve të tjera. Procedura e përmirësimit kadastral. Problematikat e hasura në praktikën gjyqësore lidhur me regjistrimin fillestar dhe procesin e përmirësimit kadastral, si dhe lidhur me regjistrimin e titujve të pronësisë të cilët figurojnë të shënuar në rradhorët e pronësisë.	20 mars		Shkolla Magjistraturës	Shkolla Magjistraturës	Tiranë, Shqipëri

	Roli i transkriptimit/regjistrimit në regjistrat e ASHK: Mjet i nevojshëm për t'i dhënë publicitetin kontratës apo pasojë e kërkimeve të padisë?					
16.	Shpronësimi si mënyrë për humbjen/fitimin e së drejtës së pronësisë mbi sendet e paluajtshme. Kriteret që duhet të përmbush kjo procedurë për të garantuar respektimin efektiv të së drejtës kushtetuese të përcaktuar në nenin 41 të Kushtetutës së RSh-së. Evolumi i praktikës gjyqësore të gjykatave shqiptare dhe GJEDNJ-së. Kufizimet e tjera në ushtrimin e së drejtës së pronës sipas legjislacionit shqiptar. Procedura administrative për realizimin humbjen/fitimin e së drejtës së pronësisë mbi sendet e paluajtshme dhe regjistrimi i tyre pranë regjistrave të pasurive të paluajtshme në administrim prej Agjencia Shtetërore e Kadastrës.	21 mars		Shkolla Magjistraturës	Shkolla Magjistraturës	Tiranë, Shqipëri
17.	Korrupsioni i funksionarëve të lartë shtetërorë ose i të zgjedhurve vendorë.	24 mars		Shkolla Magjistraturës	Shkolla Magjistraturës	Tiranë, Shqipëri
18.	Pavlefshmëria e vendimit të gjyqtarit të seancës paraprake. Mosrespektimi i dispozitave lidhur me njoftimin e të pandehurit dhe pezullimin e gjykimit në seancë paraprake, efektet mbi gjykimin e themelit. Kompetencat e gjyqtarit të themelit për konstatimin e pavlefshmërisë, detyrimi i vazhdimin të gjykimit të themelit pavarësisht elementëve të pavlefshmërisë së vendimit të gjyqtarit të seancës paraprake. Praktika gjyqësore dhe qëndrimet e Gjykatës së Lartë në rast të referimeve për konfliktin e kompetencave midis gjyqtarit të themelit dhe gjyqtarit të seancës paraprake	15 prill		Shkolla Magjistraturës	Shkolla Magjistraturës	Tiranë, Shqipëri
19.	Figurat e veprës penale të pastrimit të produkteve të veprës penale të parashikuara në nenin 287 të Kodit Penal. Vështirësi krahasimor me dispozitat analoge të vendeve të tjera. Raste të praktikës gjyqësore.	13 maj 2025		Shkolla Magjistraturës	Shkolla Magjistraturës	Tiranë, Shqipëri

20.	Kushtet dhe kriteret për caktimin e masave të sigurimit. Caktimi dhe zbatimi i disa masave njëkohësisht. Përlllogaritja e afateve në rast të ekzistencës së disa masave arrest me burg. Afatet e paraburgimit sipas nenit 263 të Kodit të Procedurës Penale, momenti i ecjes së afatit, mundësia e zgjatjes së afatit. Praktika gjyqësore lidhur me kërkesat për zgjatjen e afatit të paraburgimit dhe rastet kur afatet kanë përfunduar pa u shprehur ende gjykata me vendim për zgjatjen e tyre.	27 maj 2025		Shkolla Magjistraturës	Shkolla Magjistraturës	Tiranë, Shqipëri
21.	Arsyetimi i vendimit lidhur me masat e sigurimit. Elementët e detyrueshëm të vendimit të masës së sigurimit. Parashikimi ligjor i pavlefshmërisë për shkak të mungesës së arsyetimit të vendimit. Pasojat e deklarimit të pavlefshmërisë. Praktika gjyqësore lidhur me trajtimin e rasteve të pavlefshmërisë për shkak të mungesës së arsyetimit të vendimit.	2 qershor 2025		Shkolla Magjistraturës	Shkolla Magjistraturës	Tiranë, Shqipëri
22.	Njohja e vendimeve penale të huaja. Roli i gjykatës në njohjen e vendimeve penale, caktimin/konvertimin e dënimeve dhe dënimin që duhet të ekzekutohet në shtetin shqiptar. Problematikat e hasura në praktikë dhe praktika gjyqësore.	18 qershor 2025		Shkolla Magjistraturës	Shkolla Magjistraturës	Tiranë, Shqipëri
23.	Kompetencat e gjykatave të juridiksionit të zakonshëm lidhur me çështje të veçanta të procedurës së arbitrazhit: emërimi i arbitrave kur palët nuk bien dakord; marrja e masave të përkohshme kur gjykata e arbitrazhit nuk është formuar ende; shqyrtimi i kërkesës për anulimin e vendimit të gjykatës së arbitrazhit	26 qershor 2025		Shkolla Magjistraturës	Shkolla Magjistraturës	Tiranë, Shqipëri
24.	Provat Dixhitale	Gjatë vitit			Policia Greke	
25.	Korrupsioni në sektorin publik dhe prokurimet publike	Gjatë vitit			Drejtoria e Luftës Kundër	

					Krimet Organizuar , Policia Greke	
26.	Pastrimi i parave dhe krimet financiare.	Gjatë vitit			Drejtoria e Luftës Kundër Krimet Organizuar Policia Greke	